



SISTEMI I ICZM DHE SKEMA E AUDITIT



Koordinimi:	Marina Marković, PAP/RAC Daniela Addis, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Italinë Ina Janushi dhe Rezart Kapedani, Koordinatorë Kombëtarë të Projektit për Shqipërinë Tea Marasović, PAP/RAC
Autori:	Elisa Ulazzi
Përkthimi:	We Translate Albania
Dizajni i kopertinës:	Tessa Bachrach-Krištofić
Redaktimi i faqesjes:	Old school S.P.
Foto e kopertinës:	© N. Russo

Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e UNEP/MAP-it në lidhje me statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti ose zone ose autoriteteve përkatëse të tij, ose në lidhje me përcaktimin të kufijve të tij.

Raporti u përgatit si pjesë e projektit ndërkufitar CAMP Otranto.

Për citimet:

UNEP/MAP – PAP/RAC (2023). Sistemi i ICZM dhe Skema e Auditit. Priority Actions Programme / Regional Activity Centre (PAP/RAC), Split (Kroaci). fq. 28 + Anekset

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	1
2. Kuadri historik për përcaktimin e kriterëve të ICZM SAS	2
2.1. Roli i operatorëve ekonomikë në procesin ICZM.....	6
3. Sistemi dhe procedura e auditimit ICZM SAS	7
3.1. Procesi i auditimit	7
3.2. Dokumentet dhe instrumentet	8
3.2.1. Instrumentet dhe dokumentet për auditimin e palës së parë (i brendshëm).....	8
3.2.2. Instrumentet dhe dokumentet për auditimin e palës së tretë (i jashtëm)	8
4. Përkufizimi i treguesve të ICZM SAS	9
4.1. Arsyetimi për përzgjedhjen e kriterëve dhe treguesve	9
4.2. Treguesit përshkruar	12
4.2.1. Shtrirja operative dhe gjeografike.....	12
4.2.2. Kërkesat e përshtatshmërisë	13
4.2.3. Kushtet e ndërlidhura mundësuese me ICZM.....	14
4.3. Treguesit kualifikues.....	15
5. Vlerësimi dhe pragjet e treguesve kualifikues	20
5.1. Pragjet për etiketimin e ICZM	22
6. Instrumentet dhe përfitimet nga dhënies e ICZM SAS	23
7. Vlerësimi mbi vizibilitetin dhe promovimin e ICZM SAS	27
Shtojca 1: Matrica e koherencës së ICZM SAS	28

Lista e figurave

Figura 1. Link Lidhja ndërmjet parimeve EcAp, PHD dhe ICZM (UNEP/MAP, 2018, Kuadri konceptual për planifikimin hapësinor në Mesdhe).....	5
Figura 2. Ekstrakt i Matricës – Analiza rregullatore	28

Lista e tabelave

Tabela 1. Lista e treguesve të identifikuar dhe arsyeja e përzgjedhjes përkatëse.....	10
Tabela 2. ICZM SAS ka përzgjedhur treguesit dhe metodat përkatëse të vlerësimit.....	21
Tabela 3. ICZM SAS ka përzgjedhur treguesit dhe metodat përkatëse të vlerësimit.....	23
Tabela 4. Vlerësimi i treguesve të ICZM SAS me shkallë të ndryshme sipas rëndësisë.....	26

1. Hyrje

Menaxhimi i Integruar i Zonës Bregdetare (ICZM) është një **proces dinamik, shumëdisiplinar dhe interaktiv** për të nxitur menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e zonave bregdetare. Ky proces mbulon ciklin e plotë të mbledhjes së informacionit, planifikimit, vendimmarrjes, menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të çdo lloj aktiviteti, dhe përfshin të gjithë palët e interesit në sektorë të ndryshëm për të garantuar mbështetje të gjerë për zbatimin e strategjive, planeve dhe programeve të përcaktuara të menaxhimit.

Instrumenti ligjërish të detyrueshëm për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare të zonave bregdetare mesdhetare është **Protokolli i Konventës së Barcelonës për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare në Mesdhe** (miratuar në vitin 2008 dhe në fuqi në vitin 2011). Sipas këtij Protokoll, Palëve u është bërë thirrje të marrin masat e nevojshme për të forcuar bashkëpunimin rajonal në mënyrë që të përmbushin objektivat e ICZM. Këto masa përfshijnë ato që synojnë mbrojtjen e karakteristikave të disa ekosistemeve të caktuara bregdetare, ato që synojnë të garantojnë përdorimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare dhe ato që synojnë të garantojnë që ekonomia bregdetare dhe detare të përshtatet me natyrën e brishtë të zonave bregdetare. Në nivel ndërkombëtar, menaxhimi i zonave bregdetare trajtohet në shumë instrumente ligjore, jo domosdoshmërisht të gjitha pjesë e fushës së mbrojtjes së mjedisit. Mund të përmendim instrumente të shumta ndërkombëtare që lidhen me tema të ndryshme të ndërthurura, të cilat duhet të merren parasysh si pjesë e ICZM. Ndër këto instrumente, **Kuadri konceptual për Planifikimin Hapësinor Detar në Mesdhe** në kuadër të Konventës së Barcelonës UNEP/MAP, është veçanërisht i rëndësishëm, së bashku me Direktivën 2014/89/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 korrikut 2014

duke krijuar një kuadër për Planifikimin Hapësinor Detar (**Direktiva PHD e BE-së – DPHD – Direktiva e Planifikimit Hapësinor Detar**).

Duke pasur parasysh karakteristikat lokale mjedisore, historike dhe socio-ekonomike, një nga aktivitetet në kuadër të projektit të CAMP Otranto parashikon krijimin dhe zbatimin e një **sistemi menaxhimi dhe skemës së auditimit të ICZM (ICZM SAS), me qëllim vlerësimin dhe mbështetjen e aktiviteteve (ekonomike) publike dhe private që lidhen me ICZM në nivel lokal**.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj skeme është të vlerësojë performancën socio-ekonomike dhe mjedisore të subjekteve lokale, të mbështesë përmirësimin e tyre të vazhdueshëm drejt qëndrueshmërisë bregdetare, të validojë/certifikojë procesin dhe nismat e tyre dhe të promovojë praktikën dhe arritjet e tyre. Kjo skemë lejon **pjesëmarrjen vullnetare me çdo lloj aktiviteti, duke përfshirë ato që lidhen me sistemet lokale të prodhimit të llojeve të ndryshme të agro-ushqimit, artizanatit dhe prodhimit, turizmit të qëndrueshëm, peshkimit të përgjegjshëm dhe akuakulturës, porteve të gjelbra dhe fusha të tjera të ngjashme, duke iu referuar veçanërisht organizatave private dhe aktiviteteve të veçanta ekonomike që ndodhen brenda zonave bregdetare**.

SAS duhet të konsiderohet si **një instrument shpërblimi që njihet për aktivitetet në zonat bregdetare në kuadër të parimeve dhe objektivave të ICZM**, duke krijuar një **etiketë** që certifikon këtë aderim. ICZM SAS u zhvillua si një qasje hap-pas-hapi, siç është detajuar në **metodologjinë për zhvillimin e ICZM SAS**. Ky instrument do të vlerësohet dhe zbatohet më tej si pjesë e projekteve të ardhshme të CAMP dhe në vijim do të shtrihet në të gjithë zonën mesdhetare.

2. Kuadri historik për përcaktimin e kriterëve të ICZM SAS

Sipas protokollit ligjërish të detyrueshëm për ICZM në Mesdhe, vendimmarrësit gëzojnë të drejtën të drejtpërdrejtë të përcaktojnë strategjitë, politikat, planet dhe programet për të arritur objektivat e ICZM të përcaktuara në nenin 5 të këtij protokoll:

1. të lehtësojnë, nëpërmjet planifikimit racional të aktiviteteve, zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare duke garantuar që të merren parasysh mjedisi dhe peizazhet në harmoni me zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor
2. të ruajnë zonat bregdetare për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm
3. të sigurojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, veçanërisht në lidhje me përdorimin e ujit
4. të sigurojnë ruajtjen e integritetit të ekosistemeve bregdetare, peizazheve dhe gjeomorfologjisë
5. të parandalojnë dhe/ose zvogëlojnë efektet e rreziqeve natyrore dhe në veçanti të ndryshimeve klimatike, të cilat mund të shkaktohen nga aktivitetet natyrore ose njerëzore
6. të arrijnë koherencën ndërmjet nismave publike dhe private dhe midis të gjitha vendimeve të autoriteteve publike, në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, që ndikojnë në përdorimin e zonës bregdetare.

Neni 6 i Protokollit të ICZM-së përcakton parimet e përgjithshme për ICZM (referojuni tabelës 1), në thelb ripërcakton konceptet, instrumentet dhe mjetet që duhen marrë parasysh për përdorim. Këto parime duhet të merren parasysh nga vendimmarrësit gjatë përcaktimit të dispozitave rregullatore dhe planifikuese, dhe që çdo palë e interesuar (publike ose private), pra aktori kryesor i procesit të ICZM, duhet t'i zbatojë gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre.

Objektivi gjeografik i protokollit përfshin si pjesën tokësore ashtu edhe atë detare të zonës bregdetare dhe pason me planifikimin që duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë për të dy komponentët e tij. Megjithëse planifikimi hapësinor detar (PHD) nuk përmendet në mënyrë të hollësishme, është e qartë se planifikimi i hapësirës detare është një koncept i rënë dakord i pasqyruar tashmë në Protokoll.

PHD (PHD – Planifikimi Hapësinor Detar) mund të përkufizohet si “procesi publik për analizimin dhe përcaktimin e shpërndarjes së veprimtarive njerëzore në hapësirë dhe në kohë në zonat detare për të realizuar objektivat ekologjike, ekonomike dhe sociale që zakonisht specifikohen nëpërmjet një procesi politik”.¹ Në praktikë, PHD përfshin ndërmarrjet dhe nismat për përdorimin e hapësirave detare në përputhje me qëllimet, vlerat dhe objektivat e pranuar nga shoqëria. PHD mund të përgatisë plane, leje dhe vendime të tjera administrative për shpërndarjen në hapësirë dhe në kohë të aktiviteteve dhe përdorimeve përkatëse ekzistuese dhe të ardhshme në ujërat detare, por edhe vizione të ndryshme jodetyruese, strategji, koncepte planifikimi, udhëzime dhe parime qeverisjeje që lidhen me përdorimin e hapësirës detare.

Në kuadrin e Konventës së Barcelonës, PHD është përcaktuar më tej si pjesë e [Kuadrit Konceptual për Planifikimin Hapësinor Detar në Mesdhe](#) që:

- ofron një kontekst të përbashkët për Palët Kontraktore (PK) për zbatimin e PHD në Rajonin e Mesdheut
- konsideron PHD si mjetin apo procesin kryesor për zbatimin e ICZM në pjesën detare të zonës bregdetare.

¹ Ehler, Charles dhe Fanny Douvère. *Vizionet për një ndryshim në det. Raporti i Seminarit të Parë Ndërkombëtar për Planifikimin Hapësinor Detar*. Komisioni Ndërqeveritar Oqeanografik dhe Programi Njeriu dhe Biosfera. Manuali dhe Udhëzuesi i IOC, 46: Dosja ICAM, 3. Paris: UNESCO, 2007

Kutia 1. Parimet e ICZM

- a) Pasuria biologjike dhe dinamika e natyrshme dhe funksionimi i zonës midis baticës dhe zbaticës dhe **natyra plotësuese dhe e ndërvarur e pjesës detare dhe asaj tokësore** përbën një subjekt të vetëm dhe do të merren parasysh në mënyrë specifike.
- b) Të gjithë elementët që kanë të bëjnë me sistemet hidrologjike, gjeomorfologjike, klimatike, ekologjike, socio-ekonomike dhe kulturore do të merren parasysh **në mënyrë të integruar**, që të mos tejkalohet kapaciteti mbajtës i zonës bregdetare dhe të parandalohen efektet negative të fatkeqësive natyrore dhe zhvillimit.
- c) **Qasja e ekosistemeve (EcAp)** ndaj planifikimit dhe menaxhimit bregdetar do të realizohet në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare.
- d) Duhet të sigurohet një **qeverisje** e përshtatshme që mundëson **pjesëmarrjen** e duhur dhe në kohë në një proces transparent vendimmarrjeje nga popullsia vendase dhe palët e interesit në shoqërinë civile që janë të angazhuara me zonat bregdetare.
- e) Nevojitet një **koordinim institucional** ndërmjet sektorëve që është organizuar për shërbime të ndryshme administrative dhe autoritete rajonale dhe vendore kompetente në zonat bregdetare.
- f) Nevojitet hartimi i **strategjive, planeve dhe programeve të përdorimit të tokës** ku përfshihet zhvillimi urban dhe aktivitetet socio-ekonomike, si dhe politikat e tjera sektoriale përkatëse.
- g) **Shumëllojshmëria dhe diversiteti i aktiviteteve** në zonat bregdetare do të merret parasysh dhe do t'u jepet përparësi, sipas rastit, shërbimeve publike dhe aktiviteteve që kërkojnë, për sa i përket përdorimit dhe vendndodhjes, afërsisë së drejtpërdrejtë me detin.
- h) Duhet të balancohet **shpërndarja e përdorimeve** në të gjithë zonën bregdetare dhe të shmanget përqendrimi i panevojshëm apo shtrirja urbane.
- i) Duhet të bëhen **vlerësime paraprake** të shoqëruara me aktivitetet e ndryshme njerëzore dhe infrastrukturën e duhur në mënyrë që të parandalohet dhe reduktohet ndikimi i tyre negativ në zonat bregdetare.
- j) Duhet të **parandalohet dëmtimi** i mjedisit bregdetar dhe, aty ku mundet, të bëhet **restaurimi** i duhur.

Për më tepër, Protokollin ICZM si dhe **Kuadri Konceptual për Planifikimin Hapësinor Detar në Mesdhe** theksojnë domosdoshmërinë për të marrë parasysh konceptin e **"ndërveprimeve tokë-det" (LSI)** (referojuni tabelës 2). Në fakt, analiza e ndërveprimeve ndërmjet komponentëve tokësorë dhe detarë të bregdetit përbën një element kyç të procesit ICZM dhe përfshin proceset ekologjike që kalojnë kufirin e vijës bregdetare, ndërveprimet midis aktiviteteve tokësore dhe atyre detare apo vlerave socio-kulturore si dhe planifikimin e proceseve. Analiza e LSI (ndërveprimi tokë-det) nuk është një disiplinë apo kërkesë e re, por një komponent i brendshëm i procesit të ICZM, i cili nevojitet për të siguruar që komponentët tokësorë dhe detarë të zonës bregdetare janë planifikuar dhe menaxhuar në një mënyrë të ndërlidhur dhe koherente.

Protokollin ICZM shpjegon rëndësinë e përdorimit të një qasjeje ekosistemesh për planifikimin dhe menaxhimin bregdetar (përfshirë marinën) si një qasje strategjike drejt zhvillimit të qëndrueshëm në rajon që integron të tre komponentët e tij, d.m.th., mjedisor, social dhe

ekonomik. Qasja e ekosistemit shkon përtej kontrollit të çështjeve të veçanta, specieve ose funksioneve të ekosistemit në izolim. Përkundrazi, ai njeh sistemet ekologjike për atë që janë: kombinime të pasura elementësh që ndërveprojnë me njëri-tjetrin vazhdimisht. **Qasja e Ekosistemeve (EcAp)** përbën gjithashtu parimin udhëzues për të gjithë zbatimin dhe zhvillimin e politikave të ndërmarra nën kujdesin e Konventës së Barcelonës UNEP/MAP, me objektivin përfundimtar arritjen e statusit të mirë mjedisor (GES) të Detit Mesdhe dhe Bregdetit. Kjo vlen edhe për Protokollin ICZM dhe planifikimin përkatës të aktiviteteve të marinës tokësore dhe detare, duke përfshirë zbatimin e PHD.

Deri më tani, kuadri i zbatimit të objektivave dhe parimit të ICZM, nuk kufizohet vetëm në Protokollin e ICZM, por është i lidhur dhe i integruar në procese të përcaktimit dhe planifikimit të disa politikave dhe përfshin disa aktorë që veprojnë në zonën bregdetare. Në të vërtetë, lidhjet ndërmjet parimeve EcAp, PHD dhe ICZM janë të gjera dhe të pasqyrohen në Figurën 1.

Kutia 2. Ndërveprimet detare dhe tokësore

Termi "ndërveprime detare tokësore" (LSI) zakonisht përdoret në kontekstin e planifikimit dhe menaxhimit të zonave detare dhe bregdetare. Disa studime nxjerrin në pah orientimin e dyfishtë të LSI (ndërveprimi tokë/det, siç është toka drejt detit apo deti drejt tokës:

- a) Ndërveprimet që lidhen me proceset natyrore tokësore-detare. Implikimet e këtyre proceseve në mjedisin bregdetar dhe në aspektet socio-ekonomik bregdetar do të identifikohen dhe vlerësohen duke marrë parasysh natyrën e tyre dinamike, me qëllim përfshirjen e tyre në proceset e planifikimit dhe menaxhimit. Aktivitetet njerëzore mund të ndërhyjnë gjithashtu në proceset natyrore. Analiza e ndikimeve të pritshme të aktiviteteve tokësore dhe detare duhet të përfshijë vlerësimin e efekteve të tyre në proceset natyrore LSI dhe efektet e mundshme pasuese në burimet natyrore dhe shërbimet e ekosistemit
- b) Ndërveprimet ndërmjet përdorimeve dhe aktiviteteve tokësore dhe detare. Pothuajse të gjitha përdorimet detare kanë nevojë për instalime mbështetëse në tokë (si portet për transportin detar, marinat për jahtet ose lidhjet e rrjetit për impiantet e erës në det të hapur), ndërsa disa përdorime ekzistojnë kryesisht në pjesën tokësore (p.sh. turizmi, aktivitetet rekreative dhe transporti tokësor) zgjerojnë aktivitetet e tyre edhe në det. Këto ndërveprime do të identifikohen dhe hartohen, duke vlerësuar ndikimet e tyre kumulative, përfitimet dhe konfliktet dhe sinergjitë e mundshme, nga pikëpamja e implikimeve të tyre mjedisore, sociale dhe ekonomike (UNEP/AP PAP/RAC & Universiteti i Thesalisë, 2015).

Ndërveprimet e mundshme tokësore-detare të disa sektorëve tipikë detarë janë përshkruar gjithashtu në studimin e përgatitur nga Shipman et al. (2018) për Drejtorinë e Përgjithshme për Mjedisin e Komisionit Evropian. Këto udhëzime marrin në konsideratë sektorët e mëposhtëm: akuakulturën, shkripëzimin, peshkimin, kabllot dhe tubacionet detare, mineralet dhe minierat, portet dhe transportin detar, turizmin dhe pushimin bregdetar, energjinë e erës në det të hapur. Çdo sektor identifikon analizën LSI (ndërveprimin tokësor/detar) me gjetje kryesore të rëndësishme ku sugjerohen të dhënat kryesore, mjetet e mundshme analitike dhe menaxhimi i zbutjes, së bashku me kategoritë e palëve të interesit që do të përfshihen dhe opsionet e mundshme të menaxhimit.

Duke marrë në konsideratë qasjen e mësipërme, me nivele dhe fleksibël për vlerësimin e ndërveprimeve tokësore-detare, që bëjnë pjesë në udhëzimet metodologjike, propozohet nga PAP/RAC për një analizë LSI (ndërveprimi tokë/det): [në vijim](#).

Duhet të nënvizohet se ICZM (dhe të gjitha politikat, mjetet dhe instrumentet e tjera të lidhura/të lidhura) bazohen në pikënisjet kryesore udhëzuese të mëposhtme²:

- **Perspektiva e gjerë dhe afatgjatë:** Një nga karakteristikat kryesore të një zone bregdetare është diversiteti i saj, jo vetëm në mjedis, por në karakteristikat sociale, kulturore, institucionale dhe ekonomike. Duhet të merren parasysh të gjitha karakteristikat bregdetare, elementët dhe ndërveprimet e tyre dhe të gjitha proceset që veprojnë në zonën përkatëse edhe në kushtet e ndryshimit të kushteve me kalimin e kohës dhe parashikimeve të ardhshme. Megjithëse nuk mund të parashikojmë gjithmonë të ardhmen, çelësi është të ruajmë fleksibilitetin përballë pasigurisë. Si rrjedhojë, parimi³ i parandalimit është i zbatueshëm për të gjitha përdorimet e hapësirës dhe burimeve bregdetare.
- **Bazohuni tek njohja e kushteve specifike në fushën e interesit:** ICZM në një zonë specifike duhet të

përcaktohet në bazë të nevojave dhe kushteve, pikave të forta dhe të dobëta specifike për zonën apo dinamikën, si dhe evolucionin e zonës.

Natyrë dinamike e sistemeve bregdetare duhet njohur dhe trajtuar plotësisht në planet dhe strategjitë bregdetare, veçanërisht për planifikimin e zhvillimit urban. Duhet treguar shumë kujdes për të zbutur incidencën e rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu dhe për t'iu përshtatur ndikimit të tyre mbi popullsinë bregdetare dhe investimet ekonomike.

- **Përdorni planifikimin pjesëmarrës për të arritur një marrëveshje ndërmjet palëve:** Përgjegjësia për aktivitetet e menaxhimit bregdetar shpesh ndahet midis një game të gjerë të agjencive qeveritare, shërbimeve dhe administratave që veprojnë në bazë sektoriale ose territoriale. Ka menaxhim të ndarë dhe të mbivendosur ndërmjet qeverive në nivel kombëtar dhe lokal. Si rrjedhojë, qasja ICZM duhet të përfshijë të gjithë ata që janë të përfshirë në politikën

² Peter R. Burbridge (1999). Parimet Udhëzuese për një Strategji Evropiane të ICZM. Drejt një Strategjie Evropiane për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare (ICZM). Bruksel, Belgjikë

³ https://en.wikipedia.org/wiki/Precautionary_principle

dhe vendimmarrjen sektoriale, duke filluar nga niveli lokal në atë rajonal, kombëtar dhe evropian. Parimi i filialit do të udhëheqë caktimin e përgjegjësiwe menaxheriale ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes, por është kritike që politikat dhe veprimet në nivele të ndryshme të jenë të qëndrueshme.

Për më tepër, pjesëmarrja ofron një mjet për të shfrytëzuar njohuritë, energjinë dhe përkushtimin lokal, si dhe për të njohur siç duhet çështjet e menaxhimit bregdetar dhe perspektivave të palëve të tjera të interesit. Pronësia e procesit ofron një bazë solide për miratimin dhe zbatimin e strategjive ICZM.

- **Përdorni një kombinim instrumentesh për të arritur objektivat e menaxhimit bregdetar:** ICZM përbën një proces të vazhdueshëm dhe përsëritës, si dhe ofron një mjet për të pranuar dhe koordinuar objektiva të ndryshme për zonat bregdetare në mënyrë që të arrihen qëllime të shumta sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Në ditët e sotme ka një numër instrumentesh tashmë të zhvilluara dhe/ose në zhvillim e sipër, që mund të jenë të dobishme ose që mund të mbështesin procesin ICZM. Ndër to mund të përmendim ato që lidhen me përcaktimin e kushteve bazë të zonës bregdetare dhe ndikimet kumulative që kërkojnë veprime të menjëhershme.




Figura 1. Link Lidhja ndërmjet parimeve EcAp, PHD dhe ICZM (UNEP/MAP, 2018, Kuadri konceptual për planifikimin hapësinor në Mesdhe)

2.1. Roli i operatorëve ekonomikë në procesin ICZM

Sistemet bregdetare janë nën presionin e rritjes njerëzore dhe mjedisore dhe si rrjedhojë duhen bërë më shumë përpjekje të reja dhe novatore për të menaxhuar zonat bregdetare si sisteme funksionale të integruara⁴. Shoqëria si një sistem duke përfshirë sisteme të ndryshme funksionale (p.sh. ekonomike, ligjore, kulturore dhe të tjera) është e lidhur me sistemet ekologjike përreth, si ato individuale dhe sociale. Prandaj, duhen marrë parasysh **sistemet ekonomike, ligjore dhe sociale dhe/ose kulturore duke qenë se janë thelbësore për menaxhimin e ekosistemit bregdetar.**

Dispozitat e Protokollit ICZM trajtojnë sistemet ekonomike, sociale dhe kulturore, por kryesisht përmes rregullimit të aktiviteteve të vendimmarrësve dhe organeve administrative. Sidoqoftë, operatorët ekonomikë janë palët që konsiderohen në mënyrë indirekte.

Vendimmarrësit dhe organet administrative duhet të përcaktojnë strategji dhe të ofrojnë mjete rregullative dhe planifikuese për të lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare. Kjo përfshin prezantimin e një perspektive afatgjatë për sigurimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, ruajtjen e integritetit të ekosistemeve bregdetare, peizazheve dhe gjeomorfologjisë, si dhe parandalimin dhe reduktimin e efekteve të rreziqeve natyrore (me fokus të veçantë ndaj ndryshimeve klimatike).

Edhe nëse kërkohet koordinim ndërmjet vendimmarrësve të ndryshëm, shumëllojshmëria dhe ndarja e sistemit administrativ dhe vendimmarrës ende çon në një fragmentim të ligjeve, rregulloreve dhe planeve, të cilat ndonjëherë mbivendosen. Kjo mund të jetë veçanërisht sfiduese për çdo lloj aktiviteti (publik apo privat) që kërkohet për të vepruar në përputhje me një sistem kaq kompleks ligjesh, rregulloresh dhe planesh.

Në të njëjtën kohë, aktivitetet ekonomike janë qendrore për **zbatimin aktiv të procesit të ICZM** duke:

- Mundësuar funksionimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e ekosistemit

(p.sh. reduktimin e përdorimit të ujit ose sistemet e riciklimit, reduktimi i mbetjeve dhe krijimi i ndotësve)

- Krahasuar efektet e kundërta të ndryshimeve klimatike (p.sh. Prezantimi i një sistemi efikas energjetik për të reduktuar prodhimin e CO₂ ose për të përdorur teknologji dhe sisteme të energjisë së lëvizshme, prezantimi i brezave të gjelbër)
- Kontribuar në veprimet kërkimore dhe novatore drejt përcaktimit të teknikave dhe mjeteve të mëtejshme të qëndrueshme
- Shkëmbyer përvojën dhe praktikën më të mira dhe stimuluar operatorët e tjerë ekonomikë
- Marrë pjesë në zbatimin e rregulloreve dhe planeve (p.sh. të qenit pjesë e shoqatës së një kategorie që u jep këshilla vendimmarrësve dhe organeve administrative për nevojat dhe kufizimet e territorit ose të sektorit ekonomik të kompetencës).

Roli aktiv i një aktiviteti ekonomik bazohet në një njohje të thellë të kontekstit territorial ku ai operon, karakteristikat e tij mjedisore, kulturore, ekonomike dhe sociale, si dhe në një njohuri konkrete të të gjithë komponentëve specifikë të biznesit dhe performancës së tyre, potencialin dhe kufijtë e tyre (p.sh. teknologjik, financiar). Deri më tani, aktivitetet ekonomike mund të operojnë (për shembull) duke:

- monitoruar funksionimin e tyre dhe krijimin e bazave të të dhënave për të përcaktuar objektivin e ri për përmirësim (p.sh. kontrolli i emetimeve, konsumi i energjisë)
- shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave me institucionet përkatëse
- krijimin e sinergjive me institutet/qendrat kërkimore dhe aktivitete të tjera ekonomike në mënyrë që të zhvillohen qasje të reja biznesi dhe teknologji të reja.

ICZM SAS synon të nxisë interesin tek operatorët ekonomikë dhe aktivitetet që ndonjëherë neglizhohen nga procesi i zakonshëm i ICZM. Kjo është mënyra për të tentuar të stimulojë aktivitetet ekonomike drejt praktikave më të qëndrueshme.

⁴ https://www.marinespecies.org/introduced/wiki/Policy_instruments_for_integrated_coastal_zone_management

3. Sistemi dhe procedura e auditimit ICZM SAS

3.1.

Procesi i auditimit

Objektivi i certifikimit të ICZM për këtë studim bazohet në vlerësimin e kriterëve dhe treguesve të identifikuar për të cilët zbatohet vullnetarisht aktiviteti. Procesi i certifikimit parashikon një fazë të analizës së aktivitetit, më pas një vlerësim të treguesve të përcaktuar të mbështetur nga prova dokumentare dhe në fund një verifikim nga një organ kompetent. Deri tani bën pjesë në kategorinë e një skeme auditimi.

ISO 19011:2018 e përkufizon një auditim si një *“proces sistematik, të pavarur dhe të dokumentuar për marrjen e provave të auditimit [regjistrat, deklaratat e fakteve ose informacione të tjera që janë të përshtatshme dhe të verifikueshme] dhe vlerësimin e tij objektivisht për të përcaktuar shkallën në të cilën kriteret e auditimit [a një sërë politikash, procedurash ose kërkesash] janë përmbushur.”* Ekzistojnë tre lloje kryesore të auditimesh:

- **Auditimi i procesit:** Ky lloj auditimi verifikon funksionimin e proceseve sipas kufijve të përcaktuar. Vlerëson një operacion ose metodë kundrejt udhëzimeve ose standardeve të paracaktuara për të matur përputhshmërinë me këto standarde dhe efektivitetin e udhëzimeve
- **Auditimi i produktit:** Ky lloj auditimi përbën një ekzaminim të një produkti ose shërbimi të caktuar, si hardueri, materiali i përpunuar ose softueri, për të vlerësuar nëse produkti në fjalë është përputhje me kërkesat (p.sh. specifikimet, standardet e performancës dhe kërkesat e klientit).
- **Auditimi i sistemit:** Auditimi që kryhet në një sistem menaxhimi. Mund të përshkruhet si një aktivitet i dokumentuar që kryhet për të verifikuar, dokumentuar dhe zbatuar në përputhje dhe në lidhje me kërkesat e specifikuara nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të provave objektive që elementët e zbatueshëm të sistemit janë të përshtatshëm dhe efektivë dhe janë zhvilluar.

Auditimi mund të klasifikohet gjithashtu si i brendshëm ose i jashtëm, në varësi të ndërlidhjeve ndërmjet pjesëmarrësve.

Auditimi i palës së parë (ose **auditimi i brendshëm**) kryhet brenda organizatës për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të saj kundrejt procedurave ose metodave të veta dhe/ose kundrejt standardeve të jashtme të miratuara nga (vullnetarisht) ose të imponuara (të detyrueshme) në organizatë. Auditimi i palës së parë përbën një auditim të brendshëm që kryhet nga auditues që janë të punësuar nga organizata që auditohet, por që nuk kanë interes të veçantë në rezultatet e auditimit të zonës që auditohet.

Auditimi i palës së tretë (ose **auditim i jashtëm**) kryhet nga një organizatë e pavarur audituese e cila është e lirë nga çdo konflikt interesi. Pavarësia e organizatës së auditimit është një komponent kyç i auditimit të palës së tretë. Auditimet e palëve të treta mund të rezultojnë në certifikim, regjistrim, njohje, një çmim, miratim licence, një citim, një gjobë ose një gjobë të vënë nga organizata e palës së tretë ose një palë e interesuar.

Skema e auditimit ICZM SAS parashikohet të marrë formën e një kombinimi të auditimit të palës së parë dhe auditimit të palës së tretë (organi kompetent ose një organizatë e tretë). Në mënyrë specifike:

- subjekti zbatues i aktivitetit, duke përdorur dokumentet dhe mjetet e zhvilluara të ICZM SAS, kryen një auditim të brendshëm dhe i dërgon (vetë)vlerësimin, së bashku me të gjithë informacionin dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara, organit kompetent.
- Organi kompetent kryen një kontroll jashtë zyrës (auditim i palës së tretë) të të gjithë informacionit të mbledhur dhe kryen vlerësimin përfundimtar. Organi kompetent mund të kërkojë më shumë informacion dhe shpjegime dhe mund të kryejë inspektime në zyrë.

Në përfundim të procesit, organi kompetent lëshon një raport auditimi dhe nëse plotësohen kufijtë e përcaktuar, publikon certifikimin, duke e etiketuar aktivitetin si të orientuar nga ICZM.

Duhet theksuar se ICZM SAS do të lejojë identifikimin e të metave të aktivitetit për të cilin menaxherët përkatës

duhet të përcaktojnë veprime korigjuuese ose objektiva për përmirësime në mënyrë që të rritet respektimi i objektivave dhe parimeve të ICZM për të përmbushur pragun e kërkuar të certifikimit.

Veprimet dhe objektivat korigjuuese dhe/ose parandaluese për përmirësimin e vlerësimit të përgjithshëm do të identifikohen gjatë procesit të auditimit: nga aktiviteti që vullnetarisht mund të përcaktojë dhe angazhohet për veprimet zbatuese, ose nga organi kompetent përmes sugjerimeve dhe rekomandimeve për të përmirësuar sjelljen e ICZM.

Siç përcaktohet në shtyllat e saj, ICZM është një proces i vazhdueshëm që synon përmirësim të vazhdueshëm. Në të njëjtën mënyrë, ICZM SAS synon të vlerësojë përpjekjet e aktivitetit drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbështesë përshtatjet e menaxhimit në drejtim të mbrojtjes së zonave bregdetare. Prandaj, certifikimi ICZM SAS duhet të mirëmbahet, ndërsa procesi i vlerësimit duhet të kontrollohet dhe/ose të përsëritet gjatë viteve.

3.2. Dokumentet dhe instrumentet

Duhet të përcaktohet një grup dokumentesh dhe instrumentesh për të mbështetur procesin e auditimit dhe certifikimin përfundimtar.

Ky raport shpjegon filozofinë e ICZM SAS, zgjedhjet për kriteret dhe treguesit e tij, sistemin e klasifikimit dhe vlerësimit dhe të gjitha aspektet e tjera të ICZM SAS. **Matrica e koherencës** (SHTOJCA 1) përfaqëson një analizë të brendshme të treguesve të përzgjedhur në lidhje me rregullat dhe kuadrot kryesorë që lidhen me ICZM në nivel mesdhetar, kombëtar dhe lokal (sipas rastit).

3.2.1. Instrumentet dhe dokumentet për auditimin e palës së parë (i brendshëm)

- **Udhëzime për aplikantët e ICZM SAS** (ANEKSI 1): Dokumenti përshkruan në mënyrë të qartë, dhe të thjeshtë konceptin mbi të cilin mbështetet ICZM

SAS. Në të përfshihet një përshkrim dhe arsye të qartë të treguesve të vlerësimit ku ilustron sistemi i vlerësimit (përfshirë rëndësinë relative të treguesve). Përfshihet gjithashtu një përshkrim i përdorimit të instrumenteve (me referencë specifike për Matricën e koherencës).

- **Modeli i raportimit të auditimit të palës së parë** (ANEKSI 2): Një dokument model që duhet ta plotësojë dhe ta kthejë aplikanti. Modeli tregon gjithashtu se cilat dokumente mbështetëse duhet të sigurohen si dëshmi për çdo vlerësimi tregues, si dhe një listë kontrolli përfundimtare (udhëzim për aplikantin që të kontrollojë nëse ka plotësuar të gjitha seksionet përshkruese të duhura dhe të ketë ofruar të gjitha dokumentet mbështetëse të kërkuara). Aplikanti është drejtpërdrejt përgjegjës për informacionin e ofruar. Sigurimi i të dhënave dhe informacioneve të rreme ose jo të besueshme përbën përjashtim nga certifikimi.
- **Modeli i vetë-deklarimit të përputhshmërisë** (ANEKSI 3): Një vetëdeklarim që duhet ta plotësojë dhe ta kthejë aplikanti. Deklarata përmban një listë të *nulla osta* në fjalë dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me autorizimet e bazuara në plane, ligje dhe rregullore.

3.2.2. Instrumentet dhe dokumentet për auditimin e palës së tretë (i jashtëm)

- **Tabela e vlerësimit** (ANEKSI 4): Rrjeti që verifikon plotësinë e auditimit të palës së parë. Organi kompetent mund të kërkojë integritet e nevojshme nëse mungojnë disa seksione ose dokumente.
- **Modeli i raportit të verifikimit (auditi)** (ANEKSI 5): Modeli për raportin e vlerësimit bazuar në informacionin dhe dokumentet mbështetëse që ofrohen nga aplikanti dhe/ose që rezultojnë nga kontrollet në zyrë të kryera nga organi kompetent. Aplikantit mund t'i kërkojnë më shumë informacione dhe shpjegime në rast të mospërputhjes së gjykimit. Kjo mund të përsëritet derisa informacioni dhe arsyetimet të konsiderohen të pranueshme.

Së fundi, raporti duhet të tregojë rezultatin e procesit të auditimit, si dhe nëse është dhënë certifikimi.

4. Përkufizimi i treguesve të ICZM SAS

Hapi i parë për përcaktimin e kriterëve të ICZM SAS për etiketimin vullnetar të ICZM për aktivitetet publike dhe private mbështetet në identifikimin e parimeve dhe instrumenteve të ICZM që mund të vihen në zbatim për çdo lloj aktiviteti. Kriteret e ICZM SAS do të përcaktohen për të vlerësuar angazhimin ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare duke vlerësuar në të njëjtën kohë se si dhe në çfarë mënyre po luan rolin e tij aktiviteti në procesin e ICZM.

ICZM SAS nuk synon vlerësimin e **përputhshmërisë së një aktiviteti me ligjet, rregulloret dhe planet**. Përkundrazi, është një kusht i rëndësishëm paraprak për të hyrë në procesin e certifikimit. ICZM SAS synon të vlerësojë nivelin e angazhimit të një aktiviteti përtej kufijve, limiteve, pragjeve dhe kërkesave të përcaktuara me ligj ose planet territoriale, duke synuar të kontribuojë më tej (në mënyrë aktive dhe vullnetare) në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare.

4.1. Arsyetimi për përzgjedhjen e kriterëve dhe treguesve

Duke u bazuar në kuadrin e ICZM të përshkruar në seksionin 2, kriteret për etiketimin e ICZM SAS janë përcaktuar me qëllim që të vlerësohet zbatimi i një aktiviteti (publik ose privat) me parimet dhe objektivat

e ICZM, duke marrë parasysh menaxhimin e përgjithshëm të aktivitetit dhe instrumentet e përdorura për zbatimin e tij.

Identifikohen dy kategori kriteresh:

1. **Treguesit përshkrues**, të cilët përshkruajnë kontekstin (gjeografik dhe rregullator) të veprimtarisë. Ata duhet të mundësojnë:
 - identifikimin e zonës së fokusit/ shtrirjes së operacioneve të aktivitetit (në lidhje me zonën bregdetare të referencës)
 - verifikimin e përputhshmërisë me ligjet, rregulloret dhe planet si kusht paraprak
 - identifikimin e kushteve kufitare të lidhura me ICZM sipas të cilave zbatohet ose do të zbatohet aktiviteti.
2. **Treguesit kualifikues** kërkohen për të identifikuar dhe vlerësuar përafrimin e aktivitetit me parimet e ICZM dhe masat dhe instrumentet e përdorura dhe të zbatuara. Ato i nënshtrohen sistemit të vlerësimit dhe klasifikimit të ICZM SAS.

Për secilin tregues, arsyeja e përzgjedhjes së tij paraqitet në tabelën e mëposhtme dhe shpjegohet kryesisht në kapitujt në vijim.

Tabela 1. Lista e treguesve të identifikuar dhe arsyeja e përzgjedhjes përkatëse.

Treguesit	Arsyeja
Treguesit përshkrues	
Shtrirja operative dhe gjeografike	
Përshkrimi i aktivitetit	<p>Nevojitet një përshkrim i aktivitetit për të përcaktuar kontekstin.</p> <p>Aplikanti për etiketën ICZM duhet të ofrojë një përshkrim të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës të objektivave të përgjithshme dhe specifike të aktivitetit dhe rezultateve të tij të pritshme, të metodologjive që priten të zbatohen, grupeve të synuara dhe përfituesve përfundimtarë, si dhe informacion mbi afatin kohor të zbatimit të tij.</p> <p>Për sa i përket aktiviteteve ekonomike është e rëndësishme të sigurohet informacion edhe për madhësinë e operatorit ekonomik (p.sh. SME, ndërmarrje të mëdha), shërbimet dhe produktet e dhëna, llojin e klientëve dhe furnitorëve dhe, sipas rastit, të departamenteve të ndryshme.</p>
Fusha e fokusit	<p>Zona e ndikimit të aktivitetit duhet të identifikohet dhe përshkruhet qartë në mënyrë që të kontekstualizohet zona bregdetare e referencës. Përshkrimi në fjalë përfshin informacion mbi zonën gjeografike të aktivitetit që zbatohet, duke adresuar gjithashtu një referencë për zonën bregdetare (p.sh. nëse ajo përfaqëson një pjesë të kufizuar ose të madhe të zonës bregdetare, të gjithë zonën bregdetare siç përcaktohet nga autoritetet, nëse tejkalon kufijtë e zonës bregdetare dhe/ose nivelet administrative, nëse zona merr në konsideratë të gjithë ekosistemin ose një pjesë të tij).</p>
Kërkesat e përshtatshmërisë	
Kërkesat e përshtatshmërisë	<p>Çdo aktivitet që zbatohet për etiketën ICZM duhet të jetë në përputhje me të gjitha planet dhe rregulloret të cilave u nënshtrohen. Duhet të sigurohet një vetëdeklarim. Mund të kërkohen dokumente bazë mbështetëse.</p> <p>Duhet të sigurohet një përshkrim i çdo nulla osta dhe autorizimeve përkatëse, duke përfshirë referencën ndaj planeve, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, duke përfshirë gjithashtu informacionin përkatës, si autoriteti lëshues, data e lëshimit, periudha e vlefshmërisë, data e rinovimit (sipas rastit). Duhet të kërkohet informacion për programet e monitorimit ose kontrollet periodike të kërkuara nga autoritetet sipas rastit.</p>
Kushtet kufitare të mundshme që lidhen me ICZM	
Qeverisja	<p>Palët e e interesit kanë të drejtë të promovojnë koordinimin e duhur midis autoriteteve kompetente si për marinën ashtu edhe për pjesët tokësore të zonave bregdetare në shërbime të ndryshme administrative, në të gjitha nivelet përkatëse dhe për të siguruar skemat e duhura të qeverisjes, në veçanti koordinimi institucional ndër-sektorial dhe me shumë nivele dhe pjesëmarrja e duhur, për shembull duke promovuar dhe zbatuar konsultime institucionale të organizuara ndër-sektoriale, negociata dhe marrëveshje shumëpalëshe.</p> <p>Aplikanti duhet të sigurojë një përshkrim të nivelit të ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së perceptuar nga skema e përgjithshme e qeverisjes që zbatohet nga palët përkatëse të interesit në zonën bregdetare në lidhje me aktivitetin e tij dhe prioritetet përkatëse. Ai duhet të sigurojë gjithashtu një përshkrim të iniciativave përkatëse në lidhje me nismën/aktivitetin e tij, duke sqaruar se si është ose do të përfshihet nisma/aktiviteti dhe cilat janë përfitimet e regjistruara ose të pritshme.</p>
Njohuritë e sfondit territorial dhe linjat bazë	<p>Disponueshmëria e të dhënave dhe informacionit, si baza/gjendja fillestare e kushteve shoqërore dhe mjedisore, treguesit, vlerësimet e rrezikut dhe hartat, janë thelbësore për përcaktimin e veprimeve drejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe të përkushtuar për zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>Aplikanti duhet të sigurojë një përshkrim të studimeve përkatëse, bazës së të dhënave, programeve të monitorimit, treguesve të vënë në dispozicion nga institucionet përkatëse (vendimmarrës, institucione kërkimore) në lidhje me veprimtarinë e tij, duke sqaruar se si merren ose do të merren parasysh këto mjete/instrumente për zbatimin e aktivitetit dhe si dhe në çfarë mase do të kontribuojnë në vetë aktivitetin.</p>
Treguesit kualifikues	
Përshkruesi 1: Vizioni dhe angazhimi	
1.1 Vizioni dhe qëllimi	<p>Nëse nuk ka një vizion dhe qëllim të përcaktuar qartë, dhe nëse ky nuk merr parasysh asnjë nga objektivat dhe parimet e ICZM-së, aktiviteti nuk mund të konsiderohet si i orientuar nga ICZM.</p> <p>Deri më tani, aplikanti duhet të sigurojë një përshkrim se si dhe në çfarë mase ai i konsideron ose merr parasysh objektivat dhe parimet e ICZM që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të bregdetit me kusht që të përcaktohet një vizion/mision i qartë (ose i ngjashëm) i aktivitetit. Aplikanti duhet të përfshijë gjithashtu referencë për grupimet për çdo politikë, strategji ose program të rëndësishëm për menaxhimin e zonës bregdetare në rajon. Duhet të kërkohet dëshmia e vizionit dhe misionit të aktivitetit (p.sh. Linku në faqen e internetit).</p>

Treguesit	Arsyeja
1.2 Angazhimi	Duke iu referuar vizionit dhe misionit (duke marrë parasysh objektivat dhe parimet e ICZM), aplikanti përshkruan nëse dhe në çfarë mase është i angazhuar zyrtarisht drejt zbatimit të vizionit duke përcaktuar objektiva specifike (preferohet SMART ⁵). Referenca ndaj treguesve të përcaktuar të performancës (lloji dhe objektivat afatshkurtra dhe/ose afatgjata) do të përfshihet në përshkrim sipas rastit.
Përshkruesi 2: Instrumentet për zbatimin e vizionit dhe angazhimeve	
2.1 Masat për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare	Çdo aktivitet, sipas vizionit dhe planit të aktiviteteve, duhet të presë ndërmarrjen e masave në lidhje me parimet dhe objektivat e ICZM. Aplikanti duhet të sigurojë një përshkrim se si dhe cilat masa janë planifikuar ose janë planifikuar ose parashikuar të zbatohen. Informacioni mbi afatin kohor për zbatimin e tyre (p.sh. një herë, i kufizuar në kohë, në mënyrë të vazhdueshme) dhe mbi alokimin financiar të kushtuar këtyre masave do të përfshihet në përshkrim.
